



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	14.01.2016
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK 03-02-4673/15
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Skender Tullumi – Drejtor i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Gjakovës
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuari z. Tullumi,

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK 03-02/4673/15), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (LPKI), Agjencia bënë “*këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave*” (Neni 19, pika 1.5 e Ligjit nr. 04/L-051)

Kërkesa juaj ka të bëjë me sqarimin nga Agjencia kundër Korrupsionit, lidhur me situatën se a ka konflikt interesi nëse gjatë ushtrimit të funksionit publik të Drejtorit të Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Gjakovës punoni edhe si bashkëpunëtor në kompani të ndryshme, me orar jo të plotë.

Në pyetjen tuaj lidhur me këtë çështje ju keni përmendur edhe dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, të cilat lejojnë realizimin e të ardhurave në bazë të së drejtës së autorit, patentës e të ngjashme.

Po ashtu keni deklaruar se keni edhe licencën për kryerjen e punëve gjeodezike dhe kadastrale, të cilën ia keni bashkangjitur materialit.

Bazuar në këto të dhëna, ju informojmë se kjo situatë është e rregulluar me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (nr. 04/L-51), për mbikëqyrjen dhe zbatimin e të cilit është përgjegjëse Agjencia.

Ky ligj lejon ushtrimin e disa veprimtarive nga zyrtari i lartë, krahas ushtrimit të funksionit publik, e të cilat janë të parapara në dispozitat e nenit 10.

Po ashtu ligji parasheh disa kufizime për zyrtarët e lartë, (në të cilën kategori hyn edhe funksioni juaj i drejtorit) të cilat janë të përcaktuara në nenin 16.

Në paragrafin 2 të këtij neni thuhet se: *“zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni”*.

Ky edhe është rekomandimi që iu bën Agjencia, që ushtrimi i funksionit të zyrtarit të lartë dhe ushtrimi i veprimtarisë private si ekspert i licencuar, është i ndaluar me dispozitën e sipërcituar.

Me respekt!

